



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

0A nr. 1104/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Laura Guguli kandidat për asamble të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren, paraqitur kundër Qendrës së numrimit të rezultateve, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Laura Guguli kandidate për asamble komunale në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, Laura Guguli anëtare e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kandidate për asamble komunale në komunën e Prizrenit, në të cilën ajo pretendon se ka pasur abuzim dhe manipulim të votave në vendvotimin 2007A/04R, në vendvotimin 2003A/11R si dhe në vendvotimin 2003A/04R. Në të gjitha këto qendra ajo kërkon që të bëhet rinumërimi i votave sepse dyshon që komisioneret kanë bërë manipulime me vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Laura Guguli nga komuna e Prizrenit. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1104/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.